



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1488 Prot.

Tiranë, më datë 01.12.2023

VENDIM
Nr. 587, datë 01.12.2023

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 01.12.2023:

VENDOSI:

1. Miratimin e “Raportit Arkeologjik në kuadër të projektit “Rikonstruksion objekti ekzistues 3 dhe 2 kat me ndryshim funksioni, dhe shtesë në katin përdhe”, banesa e z. Lum-mir Frashëri”, Brenda Kufirit Zonë Arkeologjike “B” Durrës, me vendndodhje Bashkia Durrës, hartuar nga individ i licencuar z. Taulant Rama, **me zhvillues z. Lum-mir Frashëri**;
2. Subjekti zhvillues të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas Ligjit Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar;
3. Investitori duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve për projektin “Rikonstruksion objekti ekzistues 3 dhe 2 kat me ndryshim funksioni, dhe shtesë në katin përdhe”, banesa e z. Lum-mir Frashëri” si dhe Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt, e më pas subjekti aplikues mund të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
4. Gjatë procesit të zbatimit, nëse ndeshen gjetje rastësore siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të ndërpriten menjëherë dhe të raportohen pranë IKTK-së, sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 145 - 147;
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
6. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

7. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Klesta QIRICI

